



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 133

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA
PARTIA “SOCIALDEMOKRATE” PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25
PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Partia “Socialdemokrate” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Partia “Socialdemokrate” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore për 12 zonat zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partisë “Socialdemokrate” dhe dokumentacionin bashkëngjitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak, u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Berat**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kërkuar me 1 kandidat. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumëmemërore konstatohen parregullsi në plotësimin e formularëve të vetëdeklarimit.



2. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, nuk është në përputhje me pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk është respektuar kuota gjinore dhe ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor. Konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8. z. Besart Meta, numër rendor 10. z. Rigels Bejko, numër rendor 13. z. Klodjan Mema, numër rendor 19. zj. Evisa Valteri, numër rendor 20, z. Benard Martini, numër rendor 23, z. Denis Preci, numër rendor 25. z. Orges Shehaj, numër rendor 27. z. Gazmend Doda, numër rendor 30. z. Elis Rakipaj, numër rendor 34. zj. Aida Brahilika, numër rendor 36, zj. Flavia Nurja rezultojnë se kanë parregullsi në plotësimin e formularëve të vetëdeklarimit.
3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor duke tejkaluar numrin e kërkuar me 1 kandidat. Konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu lista shumemërore ‘Model 03’ ka mangësi në plotësim në të gjithë elementët e tij. Kandidatët me numërin rendor 3. Z. Hermes Dylgjieri, 4 z. Shpëtim Meta, 7. zj. Kejsi Cakani të listës shumemërorë të qarkut Elbasan kanë parregullsi në plotësimin e deklaratave model 03/1 dhe model 07. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore Qarku Elbasan konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 9, zj. Leme Hidri, numër rendor 10 zj. Elionida Alta, numër rendor 11, zj. Marjeta Gjoka, 12, zj. Manjola Lulashi, numër rendor 13, zj. Entela Muça, numër rendor 14. z. Ermal Muçaj, 15. z. Alban Pëllumbi, 16. zj. Anila Tushaj.
4. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Dibër**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kërkuar me 1 kandidat. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe parregullsi në plotësimin e formularëve të vetëdeklarimit.
5. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Lezhë**, nuk është në përputhje me pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk është respektuar kuota gjinore. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor për formularët “Model 03” dhe “Model 05”;
6. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Durrës**, nuk është në përputhje me pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk është respektuar kuota gjinore. Konstatohet se ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit sipas nenit 72 të Kodit Zgjedhor si dhe parregullsi në plotësimin e formularëve të vetëdeklarimit.
7. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkaluar



numrin e kërkuar me 2 kandidatë. Konstatohet se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 1. z. Julian Kodra, numër rendor 2. zj. Ina Tabaku, numër rendor 13. zj. File Qyrani.

8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Kukës**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke tejkualuar numrin e kërkuar me 1 kandidat dhe nuk është plotësuar formulari Model 05, për të gjithë kandidatët. Ka parregullsi në formularin e vetëdeklarimit për kandidatin me numër rendor 4. zj. Sabina Jorgo si dhe rezulton e pa plotësuar pika 5 e formularit të vetëdeklarimit për kandidatin me numër rendor 3. zj. Albiona Thaçi
9. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër**, mungojnë ID për kandidatët me numër rendor 4. z. Bilbil Dervishi, 6. zj. Amela Zaganjori, 8. z. Fabio Martini dhe 9. zj. Marina Duhani.
10. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet, për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kërkuar me 2 kandidat.
11. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **Qarku Fier** konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 1. zj. Oresja Baçe për arsye se mungon nënshkrimi në faqen nr. 6 si dhe kandidati me numër rendor 12. z. Klevin Durraj ka parregullsi në formularin e vetëdeklarimit.
12. Në dokumentacionin e kandidimit për kandidatët e listës shumemërore **Qarku Vlorë** konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 11. zj. Denisa Maze.

Në bazë të nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim subjektit zgjedhor, Partia “Socialdemokrate”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,



V E N D O S :

1. Kthimin për korrëjrim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë “Socialdemokrate”, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrëjruar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

